


## Nga kurrikuli në situatë mësimore

### 5 Nga kurrikuli i orientuar në qëllimin mësimor në situatë mësimore të orientuar në kompetenca

Koncepti i orientimit në veprim është i përshtatshëm të aplikohet në mësimin në shkollat profesionale. Në kundërshti me këtë qëndrojnë të dhënat e sotme kurrikulare, të cilat, kryesisht janë të ndërtuara në mënyrë sistematike profesionale e jo në mënyrë sistematike vepruese.



15: Situatë mësimore me veprim sistematik<sup>1</sup>

<sup>1</sup> Punuar nga Arta Kollçaku, Merita Tahiraj, Naim Hoxha, Besim Hoxha

## Nga kurrikuli në situatë mësimore

Gjatë hartimit të kurrikuleve si pikënisje në rend të parë ishin përmbajtjet profesionale me sistematikën e tyre në raport me shkencën e jo veprimi profesional. Këto shkenca kanë ende rëndësinë e tyre në mësimin e orientuar në veprim, mirëpo nuk përcaktojnë strukturën e mësimin. Qëllimet mësimore të kurrikuleve janë të bazuara në përmbajtje të veçanta të profesioneve dhe nuk janë formuluar qëllime tërësisht për krijimin e proceseve gjegj. detyrave të ndërlidhura profesionalisht.

Për të përmbushur zbrazëtirën në mes në mësimin të orientuar në veprim dhe kurrikuleve të orientuara në qëllimin mësimor, do të duhej që plane pune të shkollës të orientuara në kompetenca të krijojnë një urë. Një ekip i mësimdhënësve me aftësi gjithëpërshfshirëse profesionale sjell qëllimet e strukturuar sipas sistematikës profesionale dhe përmbajtjet nga modulet e kurrikulit në një ndërvarësi veprimesh (fig. 15).

### 5.1 *Plani i punës i shkollës*

Planet e punës shkollore bazohen në kurrikule dhe zhvillimin e kompetencave vepruese e vënë në qendër të mësimin. Ato mundësojnë një precizim të qëllimeve të arsimit profesional në nivel të kompetencave profesionale, personale dhe sociale dhe me këtë nuk bazohen vetëm në përmbajtje profesionale por theksojnë tërësinë.

Ato mbështesin parimin e orientimit në veprim, orientohen në procese ndërmarrësie dhe pune dhe qysh në shkollë mundësojnë një përafrim me profesionin. Ato rishikohen rregullisht dhe me këtë jo vetëm se ofrojnë një përshtatje në profilin e shkollës ( p.sh. dispozicioni, dhe kompetencat e personelit, hapësirat, mediat dhe mjetet e punës, partneritete me shkolla, probleme sociale), por edhe në pasqyrën e shkollës. Kështu që në këtë mënyrë merren parasysh edhe ndryshimet e vazhdueshme në fushën profesionale (kualifikimet kyçe, bashkëpunimi me industrinë dhe tregtinë) (fig. 16).